



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1153 Prot

Tiranë, më 21.10.2022

Nr. 1765 Dosje

VENDIM
PER PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 918 (31134-02662-80-2022) Regj.Them, të lëshuar më datë 20.05.2022 prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1765, Datë 05.10.2022 kërkesën e kreditorit Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit I.K.M.T, ndaj debitorit Shoqëria "Alko Impex Construction" Sh.p.k, në lidhje me titullin ekzekutiv, Vendim për Dënim me Gjobë Nr. 146, datë 16.07.2021.

Pasi fillova ekzekutimin e detyrueshëm duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 1049 Prot, datë 05.10.2022 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënien e sekuestros konservative tek kreditë, aksionet dhe asetet e debitorit Shoqëria "Alko Impex Construction" Sh.p.k., Z. Arbër Abazi (në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "Alko Impex Construction" Sh.p.k) dhe Z. Ada Fyshku (në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "Alko Impex Construction" Sh.p.k)

Urdhërat për vendosjen e sekuestrove konservative janë dërguar nga Përmbaruesi Gjyqësor Altin Vako pranë:

- DRSHTRR Tiranë me shkresën Nr. 1109 Prot, datë 18.10.2022
- Qendrës Kombëtare të Biznesit me shkresën Nr. 1108 Prot, datë 18.10.2022
- Bankave të Nivelit II me shkresën Nr. 1110 Prot, datë 18.10.2022

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për Ekzekutimin e plotë të Titullit Ekzekutiv më palët e lartpërmendura,

KONSTATOJ

Se pas nxjerrjes së llogarisë pranë "Banka Kombëtare Tregtare" Sh.a informohem se e gjithë shuma e detyrimit kishte kaluar në llogarinë e Përmbaruesit Gjyqësor, duke zbatuar vendimin e gjykatës.



Person Fizik "ALTIN VAKO", Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe të Ligjit Nr. 26/2019, datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 918 (31134-02662-80-2022) Regj.Them, të lëshuar më datë 20.05.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi detyrimi është shlyer tërësisht.
2. DRSHTRR Tiranë të bëjë ç’bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi Shoqëria “Alko Impex Construction” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K91628013D, të Z. Arbër Abazi,(atësia: Sherif, i datëlindjes: 30.11.1986), në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k, dhe Znj. Ada Fyshku, (atësia: Albert, e datëlindjes: 19.07.1990) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k., të cilat mund të jenë bllokuar me anë të shkresës Nr. 1109 Prot, datë 18.10.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
3. Bankat e Nivelit II të bëjnë ç’bllokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K91628013D, të Z. Arbër Abazi,(atësia: Sherif, i datëlindjes: 30.11.1986), në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k, dhe Znj. Ada Fyshku, (atësia: Albert, e datëlindjes: 19.07.1990) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k., të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1110 Prot, datë 18.10.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.
4. Qendra Kombëtare e Biznesit të beje ç’bllokimin e aksioneve apo kredive të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k, me Nr. NIPT-i: K91628013D, të Z. Arbër Abazi, (atësia: Sherif, i datëlindjes: 30.11.1986), në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k, dhe Znj. Ada Fyshku, (atësia: Albert, e datëlindjes: 19.07.1990) në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë “Alko Impex Construction” Sh.p.k., të bllokuara me anë të shkresës Nr. 1108 Prot, datë 18.10.2022 të Përmbaruesit Gjyqësor Altin Vako.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda 5-ditësh.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ALTIN VAKO



Person Fizik “ALTIN VAKO”, Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi “Gjegj Fishta”, Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39